



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:082860

Datë: 05.08.2022

Numri i dokumentit: 03302165

**P.nr.10/2011**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**, Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Mentor Hajraj, anëtarët e trupit gjykues- gjyqtarët: Nikola Petronijeviq dhe Rrahman Beqiri, me zyrtaren ligjore Shqipe Sejdiu, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Xh.A, për shkak të dy veprave penale: Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK, lidhur me nenin 19 të LPJ dhe veprës penale nga neni 8 al.6 lidhur me al. 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 07/2001, mbi autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, PP.nr.246/2002 të dt. 12.08.2002, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.06.07.2022, i cili ishte i hapur per publikun, në të cilin kanë prezantuar Prokurori i shtetit Sahit Tmava, i akuzuari Xh.A, mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av.Agim Lushta dhe te dëmtuarit F.M dhe M.M, me datën 07.07.2022, ka marrë dhe publikisht në mungesë të palëve, ka shpallur, ndërsa me datë 05.08.2022, ka përpiluar me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Kundër te akuzuarit –Xh.A**, nga i ati .. dhe ëma ..., e gjinisë .., i lindur më ..., në fshatin ... Komuna e ..., ku dhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, ka të kryer 5 klasë të shkollës fillore, i gjendje së mesme ekonomike, me numër personal ..., i martuar, baba i .. fëmijëve, ka qenë në paraburgim prej 04.07.2002 e gjerë më 04.08.2002.

**Në bazë të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 të KPP-së**

## LIROHET NGA AKUZA

**SEPSE: 1.** Më datën 04.07.2002, rreth orës 10:30 minuta, afër shitores në fshatin Abri e Ulët komuna e Skenderajt, me dashje ka filluar kryerjen e veprës penale të vrasjes ndaj të dëmtuarit M.M, por të njëjtën nuk e ka përfunduar, në atë mënyrë që për shkak të një konflikti të mëparshëm më të dëmtuarin M...dhe të dëmtuarin F.M, kur e vërejnë se në brendinë e shitores ndodhen të dëmtuarit, duke qenë në brendinë e automjetit të vet të markës “Mercedes”, disa herë shtënë në ajër nga pushka automatike e markës AK-47 nr. serik 186009, të kal. 7.62 mm dhe menjëherë largohet e pastaj sërish kthehet tek vendi i ngjarjes dhe kur vëren se të dëmtuarit janë dal nga shitorja, këtyre me automjetin e vet i afrohet dhe duke qenë në automjet nga pushka e përmendur shtënë pandërprerë në drejtim të dëmtuarit M...., por të njëjtin nuk e ka goditur, kështu që vepra ngel në tentativë.

- **Me këtë kishte për te kryer veprën penale:** Vrasje në tentativë nga neni 30.al.1. të LPK, lidhur me nenin 19 të LPJ.

**2.** Në të njëjtin vend, ditë, kohë me mjete dhe nga motivi i njëjtë si përshkruhet në pikëm 1 të këtij dispozitivi ka filluar veprën penale të vrasjes ndaj të dëmtuarit F.M, por të njëjtin nuk e ka përfunduar, njashtu që kur pushka e përmendur ka shtënë pandërprerë siç ceket në drejtim të dëmtuarit M., këto të shtëna njëkohësisht kanë qenë të drejtuara edhe në drejtim të dëmtuarit F..., por të njëjtin nuk e ka goditur, kështu që vepra ka ngelur në tentativë.

- **Me këtë kishte për te kryer veprën penale:** Vrasje në tentativë nga neni 30.al.1. të LPK, lidhur me nenin 19 të LPJ, e ndëshkuese sipas nenit 30.al.3. të LPK.

**Në bazë të dispozitës ligjore nga nenit 363 par.1 nen par.1.1 të KPP-së:**

## REFUZOHET AKUZA

**SEPSE: 3.** Gjerë më datën 04.07.2002, pa leje mbajtjen e armëve ka poseduar një pushkë automatike, të cekur në pikën 1, të këtij dispozitivi, e të cilën armë në ditën e përmendur pas orës 11:00, pjesëtarët e policisë së UNMIK-ut gjatë bastisjes në shtëpinë e tij në fshatin .. kanë gjetur dhe sekuestruar.

**- Me këtë veprim kishte për te kryer veprën penale – nga neni 8.al.6. lidhur me al.2. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 7/01, mbi autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë.**

Ne baze të dispozitës ligjore nga neni 282 par.1 dhe 2 pika 1.2 të KPP-se, në mënyrë të përhershme të pandehurit i konfiskohet arma- pushka automatike e markës AK-47 nr. serik 186009, të kal. 7.62 mm, ashtu që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi kjo arme të shkatërrohet nga Policia e Kosovës në rast se nuk evidentohet se arma është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barre të mjeteve buxhetore të gjykatës.

-Palët e dëmtuara M.M dhe F.M për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

## **A r s y e t i m i**

### ***Aktakuza;***

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën, PP.nr.246/02, e dt.12.08.2002, kundër të akuzuarit Xh.A për shkak të dy veprave penale: Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK, lidhur me nenin 19 të LPJ dhe veprës penale nga neni 8 al.6 lidhur me al. 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 07/2001, mbi autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë.

### ***Rrjedha e procedurës;***

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.68/02, të dt.24.12.2007, ka vendosur për këtë çështje penale, mirëpo me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 23.02.2011, është anuluar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P.nr.68/2002 datë 24.12.2007 dhe lënda është kthyer në rigjykim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti për krime të renda, në këtë çështje penale, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt. 06.07.2022, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar prokurori i shtetit Sahit Tmava, i akuzuari Xh.A, mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av.Agim Lushta dhe të dëmtuarit F.M dhe M.M. Seanca e shqyrtimit gjyqësor ka qenë e hapur për publikun. Shpallja publike e aktgjykimit është bere me dt.07.07.2022, në mungesën e palëve.

Në shqyrtim gjyqësor pasi që gjykata të akuzuarin e njoftoj me pasojat dhe beneficionet që parashihen me ligj e të cilat kanë të bëjnë lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtim gjyqësor, i akuzuari pas konsultimit edhe me mbrojtësin e tij u deklarua i pafajshëm për veprat penale për të cilat akuzohet.

***Fjala përfundimtare e palëve:***

Prokurori i shtetit Sahit Tmava në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.06.07.2022, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: Mbetem në tërësi pranë fjalës përfundimtare të prokurorisë e dhënë më dt.18.12.2007, sa i përket veprave penale në pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës, në të cilën fjalë përfundimtare prokurori i rastit ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzës dhe se nuk është kontestues fakti se nga i akuzuari është marrë arma automatike dhe se i njëjti kishte shtënë me të nga vetura të cilën e drejtonte e ku në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe gëzhoja, kjo është vërtetuar edhe nga deklaratat e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, po ashtu nuk është kontestues fakti se djali i axhës së të pandehurit kishte pasur një ditë para rastit një konflikt me të dëmtuarit M.M dhe F.M, po ashtu prokurori i rastit i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ti vlerësoj rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe ti shqiptoj një dënim adekuat me të cilën do të arrihej qëllimi i paraparë me ligj.

I dëmtuari M.M në fjalën përfundimtare deklaron: e përsërisë edhe një herë se jemi pajtuar me të akuzuarin dhe nuk kërkoj kompensim dëmi, nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale, kërkoj nga gjykata që të vendos sipas ligjit.

I dëmtuari F.M në fjalën përfundimtare deklaron: e përsërisë edhe një herë se jemi pajtuar me të akuzuarin dhe nuk kërkoj kompensim dëmi, nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale, kërkoj nga gjykata që të vendos sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Agim Lushta në fjalën përfundimtare deklaron: Mbetem në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë më datë.18.12.2007, e cila është paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate kishte deklaruar se pas administrimit të provave në shqyrtimet e mbajtura nuk është vërtetuar teza e akuzës se i mbrojturi im ka kryer veprat penale që i vihen në barrë kjo për arsye se në veprimet e të mbrojturit tim nuk ka ekzistuar qëllimi- dashja dhe pasojat e veprës penale të vrasjes së tentativë pasi që po të ekzistonte dashje për privim nga jeta këtë ka mundur ta bëjë lehtë pasi që nuk ka pasur ndonjë pengesë për realizimin e saj, andaj në këtë kuptim konsideroj se përmbushen elementet e veprës penale nga neni 8 pika 3 lidhur me piken 5, sipas rregullores

së UNMIK-ut, nr.2001/7 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, mirëpo në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 06.07.2022, ka deklaruar se dua të shtoj se nëse gjykata vendos të rikualifikoj veprën penale nga ato që janë në aktakuzë në vepër penale sipas nenit 8 pika 3 lidhur me pikën 5 të Rregullores së UNMIKU-ut numër 2001/07 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë ku dënimi maksimal ka qenë 10 vite, sipas nenit 90 par.3 të KPPK-së, parashihet parashkrimi në afat prej 10 vitesh për vepra penale të dënueshme nga 5 deri 10 vite, duke aplikuar nenin 91 par.6 sipas të cilit ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë filluar dyfishi i afatit të parashkrimit, konsideroj se kem të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes penale.

I akuzuari Xh.A në fjalën përfundimtare deklaroi se pajtohet me fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij.

***Provat e administruara ne shqyrtim gjyqësor;***

Gjykata ne shqyrtimin gjyqësor te mbajtur me dt.06.07.2022, ne këtë çështje penale ka administruar këto prova: në cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar të dëmtuarit M.M dhe F.M si dhe ka administruar provat materiale: Foto dokumentacionin e vendit të ngjarjes, si dhe raportin dhe mendimin e ekspertizës balistike të përpiluar nga eksperti për balistikë MD. Moslem Ali.

Ne shqyrtim gjyqësor nuk kane prezantuar dëshmitarët e propozuar ne aktakuze: B.M, M.A dhe F.A.

Sipas shkresave të lëndës del se dëshmitarit B.M, gjykata ka tentuar t'i dërgojë ftesë përmes shërbimit postar, në gjykatë është kthyer zarfi i mbyllur me konstatimin "adresa e pamjaftueshme", gjykata, përkatësisht administrata e gjykatës, këtë dëshmitarë përmes telefonit me dt.04.07.2022, e ka kontaktuar dhe e ka informuar se i njëjti duhet të paraqitet në gjykatë, për të dëshmuar në cilësinë e dëshmitarit, mirëpo edhe përkundër kësaj i njëjti nuk ka prezantuar. Sa i përket dëshmitares M.A, e njëjta po ashtu nuk ka prezantuar, për këtë dëshmitare prokurori i shtetit u tërhoq nga propozimi qe e njëjta te dëgjohet si dëshmitare, ndërsa dëshmitari F.A sipas shkresave te lendes përkatësisht procesverbalit te shqyrtimit gjyqësor te dt.17.12.2007, del se i njëjti ka vdekur.

Gjykata, bazuar ne dispozitën ligjore nga neni 338 par.1 pikat 1.3 dhe 1.1 te KPP-se, ne shqyrtim gjyqësor te mbajtur me dt.06.07,2022, me pëlqimin e palëve dhe mbrojtësit ka lexuar deklaratën e dëshmitarit B.M te dhënë ne shqyrtim gjyqësor me dt.17.12.2007, si dhe deklaratën e

dëshmitarit F.A dhënë para gjyqtarit hetues të gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më datën 26.07.2002.

***Procedimi i dëshmitareve ne shqyrtim gjyqësor;***

-Me propozimin prokurorisë ne aktakuze, gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.06.07.2022, ne cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar te dëmtuarit F.M dhe M.M.

***Dëshmitari – M.M*** është degjuar ne cilësinë e dëshmitarit ne shqyrtimin gjyqësor te mbajtur me datën e lartcekur, i njeiti ne dëshmine e tij nder te tjera ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 17.12.2007 dhe nuk kam asgjë për të shtuar por nëse ka ndodnjë pyetje do të përgjigjem. Ne pyetjet shtes deklaroi se nuk i kujtohet saktë distanca mirëpo mendoj se ka qenë diku rreth 15-20 metra, kam dëgjuar të shtëna nga automatiku dhe e kam parë të pandehurin duke e mbajtur automatikun përpjetë dhe të shtënat kanë qenë në ajër dhe jo në drejtim tone dhe se qellimi i te akuzarit ka qene qe vetem te na frikesoje pasi qe nese ai ka pasur per qellim te na vrases ka mundur ta beje nje gje te till pasi qe nuk ka qene i penguar nga askush dhe nuk ka pasur asnje penges ne mes te akuzarit dhe neve. Deklaratat e më hershme i kam dhënë më mllef pasi që ngjarja ishte e freskët dhe kam qenë i mllefosur nga ngatërresa që e kemi pasur një ditë më herët me djalin e axhës së të pandehurit, ndërsa sa i përket dëshmitarit Bahtir Mustafa ka deklaruar se i njeiti nuk e ka parë rastin pasi që i njeiti ka dalë më vonë.

I njeiti dëshmitar ne shqyrtimin gjyqësor te mbajtur me dt.17.12.2007, ka deklaruar se ditën kritike isha së bashku ne vëllain tim F... në fshatin Abri duke pritur autobusin, në një moment ka ardhë i panehuri Xh... me veturë të markes “Mercedes” ngjyrë e kuqe, e në ato çaste ka shtënë me armë në ajër, fillimisht kam qenë i kthyer me shpinë dhe nuk e kam parë në çfarë pozite ka shtënë por kur u ktheva e kam vërejtur dorën e tij që e kishte vendosë jashtë dritares dhe armën e mbante përpjetë, mendoj se distanca ka qenë diku rreth 10-15 metra mes nesh ndërsa nuk më kujtohet sa plumba ka shkrepur. Deklaron se duke e pasur parasysh distancën i pandehuri po të kishte dashur ka mundur të na vrasë pasi që nuk ka pasur asnjë pengesë ndërsa thekson se tashmë jepi pajtuar dhe nuk kemi kurfarë probleme.

***Dëshmitari – F. M,*** është degjuar ne cilësinë e dëshmitarit ne shqyrtimin gjyqësor te mbajtur me datën 06.07.2022, ndër të tjera ka deklaruar se ka kaluar një kohë e gjatë afërisht 20 vite dhe rati si rast më kujtohet mirëpo nuk më kujtohet mirë, e di që atë ditë e kam parë të pandehurin Xh...

i cili ka qenë me automjet dhe ka shtënë me një armë, nuk e di çfarë arme ka qenë, ka shtënë nga dritarja e vozitësit të veturës pjerrtas në drejtim të ajrit, ndërsa mendoj se distanca në mes nesh dhe atij ka qenë diku rreth 50 metra ose më pak. Ka deklaruar se nga shpejtësia që ka lëvizur vetura është shkaktuar një pluhur dhe plumbat e di se janë dëgjuar në ajër. Po ashtu deklaroi se mendoj se qëllimi i të pandehurit ka qenë me na frikësu për shkak të mosmarrëveshjes që ka pasur vëllai im M... me djalin e axhës së tij, pasi që nëse ka pasur qëllim të na vrasë këtë ka mundur ta bëjë sepse nuk e ka penguar askush.

Ashtu si u cek edhe me larte ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.06.07.2022, me pelqimin e paleve dhe mbrojtësit gjykata ka lexuar deklaratën e dëshmitarit B.M të dhënë në shqyrtim gjyqësor me dt.17.12.2007, dhe dëshmitarit F.A dhënë para gjyqtarit hetues të gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më datën 26.07.2002.

Dëshmitari B.M në shqyrtim gjyqësor me dt.17.12.2007, kishte deklaruar se nuk e kam parë momentin kur Xh...i- i pandehuri ka mbledhë gëzhoja në vendin e ngjarjes dhe po ashtu nuk i kam parë nënën dhe motrën e tij kur e kanë mbuluar armën me qebe.

Dëshmitari F.A, para gjyqtarit hetues të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, me dt.26.07.2002, kishte deklaruar se se ditën kritike kam qenë duke shkuar në shitore të fshatit dhe derisa isha brenda në shitore në ato momente ka kaluar “I biri i Halitit- Xh...i” me një veturë me një shpejtësi të madhe dhe unë e pyeta shitësin se çfarë ka i njejtë dhe ai më tha se i kanë disa probleme “me djemt e Mi...- F... dhe M...”, brenda në shitore ishte edhe M..., më pas u dëgjua krismë arme, e di që jashtë shitorës kanë qenë edhe B... dhe F.... dhe nga shitorja ka dalë edhe M... kurse më pas e kam dëgjuar edhe një të shtënë tjetër dhe nuk e di se kush ka shtënë e as me çfarë arme.

#### ***Administrimi i provave materiale në shqyrtim gjyqësor;***

Gjykata me qëllim që gjendja faktike të vërtetohet në mënyrë sa më të drejtë në këtë çështje penale në shqyrtimin gjyqësor i procedoi provat e propozuara nga prokuroria në aktakuzë, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.06.07.2022, dhe atë: -Dokumentacioni i vendit të ngjarjes; si dhe -Raporti dhe mendimi i ekspertizës balistike.

Nga dokumentacioni i vendit të ngjarjes u vërtetua se rasti në fjalë ka ndodhur në fshatin Abri e Poshtme komuna e Skenderajt.

Nga Raporti dhe mendimi i ekspertizës balistike, vërtetohet se është ekzaminuar një pushke automatike Ak-47, te kalibrit 7.62 mm, me numër serik 186009 dhe dëshmime të dorëzuara-gëzhjohave të shkrepura dhe sipas rezultateve të testimit vërtetohet se pushka e dorëzuar 7.62/39 mm ka shkrepur gëzhjat me numër 1,4,5 dhe 7 të cilat i kanë karakteristikat e njëjta.

***Paraqitja e mbrojtjes nga i akuzuari;***

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 06.07.2022, deklaroi se mbetet pranë deklarimeve të cilat i ka dhënë me herët për këtë rast, ndërsa ka zgjedhur që ta shfrytëzoj të drejtën e tij ligjore që të mbrohet në heshtje.

I akuzuari me datën 15.07.2002 para gjyqtarit hetues në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, ka deklaruar se fillimisht djali i axhës tim F.A ka bërë fjalë me M.M një ditë derisa ishin duke luajtur basketboll dhe më ka treguar se pasi kanë bërë fjalë me të njëjtin, M... kishte shkuar në shtëpi me i thirrë vëllezërit e vet, më pas në një dyqan- lokal privat kemi qëndruar me Fa., ku Fa.. i kam thënë të vendoset në një dhomë, e në ndërkohë ka ardhë M... së bashku me vëllain e vet F...n si dhe dy personat P.. e H..., sepse dikush i'u kishte treguar se ndodheshim aty, F... më pyeti se a është Fa... këtu dhe unë i thash jo, por ai më shtyu dhe hyri brenda me një sopatë në dorë, po ashtu edhe vëllezërit e tjerë kishin sopata në dorë, ai- F... ka dashur që ta godas Fa..., por e kam penguar dhe e kam qit jashtë dyqanit, kështu ai gjuajti me shishe të birrës në drejtim timin dhe së bashku me vëllezërit tjerë shkuan duke na kërcënuar se do të na sulmojnë. Pastaj, ka deklaruar se ditën kritike- 04.07.2002, derisa isha me veturë M... dhe F... më kanë dalë në rrugë dhe ma kanë zënë rrugën, M... mu afrua tek vetura dhe më tha të merremi vesh për dje, e në momentin kur e kam hapur derën e veturës M... u largova kurse F... më ka gjuajtur me armë dhe e ka qëlluar derën e veturës, më pas unë hyra shpejtë në veturë dhe u largova për në shtëpi. Deklaron se e kam parë F...n duke gjuajtur rafall me kallash dhe me një plumb ma ka shpuar derën dhe po ashtu e ka goditur pasqyrën e veturës, më pas kanë shtënë përtpjetë me armë 5 plumba dhe ata kanë ikur ndërsa unë u ktheva në shtëpi e pastaj kanë ardhë edhe policia dhe më kanë arrestuar.

I akuzuari Xh.A në deklaratën e tij dhënë me dt.04.07.2002, në Njësinë Rjonale të Hetuesisë, Stacioni Policor në Skenderaj, ndër të tjera ka theksuar se ditën kritike jemi gjujtur mes vete me fqinjët, konkretisht me Halili, M...n, B... dhe F...n, për shkak se djali i axhës tim ka pasur probleme me M...n kur të njëjtit ishin duke luajtur tek shkolla, ndërsa arma e llojit "AK-186009" me të cilën kam shtënë është e imja dhe e kam që nga periudha e luftës. Po ashtu deklaroi se



është e vërtetë se armën e kam përdorur por nuk kam gjuajtur në drejtim të të dëmtuarve por kam shtënë në ajër, si dhe deklarun që të dëmtuarit ditën kritike fillimisht më kanë gjuajtur me armë, pastaj unë kam shkuar në shtëpi e kam marrë armën dhe e kam përdorur siç e ceka më lartë.

***Analizimi dhe vlerësimi i provave;***

Gjykata në vështrim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPP-së aktgjykimin e bazoj vetëm në faktet dhe në provat e procedura në shqyrtim gjyqësore, të cilat prova i vlerësoi me ndërgjegje një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në baze të vlerësimit të tillë, erdhi në përfundim se nga provat e administruara ne shqyrtim gjyqësor nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale si ne piken një dhe dy te aktakuzës, për te cilat ai akuzohet sipas aktakuzës.

Sa i përket veprës penale si ne piken një (1) dhe dy (2) të aktakuzës dhe aktgjykimit, trupi gjykues i ka dëgjuar ne shqyrtim gjyqësor të mbajtur me dt.06.07.2022, te dëmtuarit- dëshmitarët F.M dhe M.M.

Dëshmitari M.M ndër të tjera ka deklaruar se është e vërtetë se i pandehuri Xh... ka shtënë me armë, mirëpo ka shtënë në drejtim të qiellit pra në ajër dhe jo në drejtim timin dhe të vëllait tim dhe mendoj se qëllimi i tij ka qenë të na frikësoj pasi që nëse kishte pasur qëllim të na vrasë këtë ka mundur ta bëjë lehtë sepse nuk ka pasur asnjë pengesë. Në këtë shqyrtim po ashtu ka deklaruar se deklaratat e më hershme i kam dhënë me mllef pasi që ngjarja ka qenë e freskët dhe kam qenë i mllefosur nga ngatërresa që e kemi pasur një ditë më herët me djalin e axhës së të pandehurit.

Po ashtu edhe dëshmitari F.M ka deklaruar se ditën kritike i pandehuri Xh... ka gjuajtur me armë dhe gjuajtja ka qenë pjerrtas në drejtim të qiellit nga dritarja e automjetit të cilën e drejtonte i njejti. Po ashtu ka deklaruar se mendoj se qëllimi i të pandehurit ka qenë të na frikësoj pasi që nëse ka pasur qëllim të na vrasë këtë ka mundur ta bëjë pasi që nuk e ka penguar askush.

Sa i përket veprave penale te përshkruara ne pikat një (1) dhe dy (2) te aktakuzës dhe aktgjykimit, gjykata ne shqyrtim gjyqësor, ashtu si u cek me lart vetëm i ka lexuar deklarinmet e dëshmitarëve B.M dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 17.12.2007 dhe të dëshmitarit F.A dhënë para gjyqtarit hetues të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë me datë 26.07.2002.

Per veprat penale te pershkruara si ne pikat një (1) dhe dy (2) ,te aktakuzes dhe aktgjykimit, gjykata vetem ka lexuar deklarinmet e dëshmitarëve B.M dhe F.A, mirëpo të njëjtit nuk ishin

dëshmitar okular dhe deklaratat e tyre janë të bazuara në atë se çfarë kanë dëgjuar dhe jo se çfarë kanë parë, asnjëri nga këta dëshmitarë nuk e ka parë të pandehurin Xh... nëse ka gjuajtur në drejtim të të dëmtuarve M...dhe F.M, kurse që të dy theksojnë se e kanë parë të pandehurin duke kaluar me veturë dhe më pas i kanë dëgjuar edhe të shtënat e armës, por asnjëri nga këta dëshmitarë nuk e ka parë të pandehurin nëse të dëmtuarve i'a ka drejtuar armën me qëllim që të njëjtit privojë nga jeta.

Dëshmitarët M...dhe F.M në shqyrtimin e fundit gjyqësor, konkretisht të datës 06.07.2022, që të dy kanë deklaruar se i pandehuri nuk ka shtënë në drejtim të tyre, i njëjti ka shtënë me armë por në drejtim të qiellit dhe qëllimi ka qenë që të na frikësoj sepse nëse i njëjti ka pasur qëllim të na vrasë këtë lehtë ka mundur ta bëjë pasi që nuk e ka penguar askush dhe asgjë. Po ashtu, kanë deklaruar se në fazat e më hershme gjatë deklaramit të tyre kanë qenë të mllefosur për shkak se ngjarja lidhur me këtë rast ishte e freskët dhe deklaratat i kemi dhënë me mllef. Në këtë kuptim të gjitha deklaratat e lartcekura të dëshmitarëve janë në përputhje me njëra tjetrën dhe në asnjëri nga dëshmitarët e cekur më lart nuk kanë deklaruar se i pandehuri Xh... ka shtënë në drejtim të të dëmtuarve.

Gjykata po ashtu pas analizimit të të gjitha provave materiale dhe personale, vlerësoi se në veprimet e të pandehurit nuk ka ekzistuar dashja apo qëllimi që të dëmtuarit ti privoj nga jeta, duke pasur parasysh pozitat e tyre, distancën midis tyre, llojin e armës se përdorur dhe numrin e plumbave të shkrepur, i akuzuari me këtë rast po te kishte dashur t'i privoje nga jeta me siguri se këtë e kishte realizuar, përkundrazi i akuzuari me këtë rast nuk ka manifestuar dashjen e tij që të dëmtuarit t'i privoje nga jeta por vetëm t'i frikësoj, i mllefosur nga rasti që ka ndodhur një dite me pare mes të dëmtuarve dhe djalit të axhës së tij. Ky fakt vërtetohet edhe nga deklarimi të dëmtuarve në shqyrtim gjyqësor kur thonë “po të kishte dashur të na vras këtë ka mundur ta bëjë pasi që nuk e ka penguar askush dhe asgjë”, si dhe “qëllimi i tij ka qenë vetëm të na frikësoj”.

Për gjykatën nuk është kontestuese fakti se i akuzuari ka poseduar armë ditën kritike dhe se me të njëjtën ka shtënë pasi që e njëjta armë edhe është konfiskuar nga policia e Kosovës dhe vet i pandehuri e ka pranuar se arma është e tij dhe se me të njëjtën ka shtënë në drejtim të qiellit ditën kritike, fakt ky që vërtetohet edhe nga deklarimi i dëshmitarëve M...dhe F.M kur deklarojnë se i pandehuri nga dritarja e veturës e ka nxjerrë tytën e automatikut pjerrtas dhe ka shtënë në drejtim të ajrit.

Gjykata konsideron se gjatë shqyrtimit gjyqësor duhet që nga dyshimi i bazuar mirë të arrihet në bindshmëri, sepse për shqiptimin e vendimit gjyqësor me të cilin i akuzuari shpallet fajtor gjithëherë kërkohet krijimi i bindshmërisë në nivel më të lartë, krijimi i bindjes për bollshmerinë e materialit provues, i bindjes për saktësinë e tij që do të thotë arritja e sigurisë se gjendja faktike e vërtetuar është e saktë. Është e nevojshme që gjykata të bindet plotësisht për ekzistimin e gjendjes faktike vetëm atëherë kur është vërtetuar pa mëdyshje kur ekzistimi i tij qëndron jashtë çdo dyshimi. Konsiderohet se faktet janë vërtetuar në mënyrë të plotë po qe se gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave të proceduara sipas bindjes së brendshme konsideron që faktet ekzistojnë dhe nuk ka kurrfarë dyshimi për ekzistimin e tyre, çka në rastin konkret munguan provat të mjaftueshme qe e vërtetojnë se i akuzuari Xh.A, i ka kryer veprat penale si ne piken nje dhe dy te aktakuzës për te cilat ai akuzohet.

Andaj, gjykata para së të marr aktgjykimin lirues për të akuzuarin Xh.A, i analizoj dhe i vlerësoi të gjitha provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor përkitazi me këtë çështje penale konkrete dhe sipas bindjes së lirë gjyqësore gjykata nga arsyet që kemi numëruar si me lart në rastin konkret vlerësoi së nuk ka prova të mjaftueshme që e vërtetojnë së ky i akuzuar i ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet si ne piken nje dhe dy te dispozitivit te aktakuzës, për arsye se në veprimet e të akuzuarit nuk ka ekzistuar qëllimi- dashja qe te dëmtuarit t'i privoje nga jeta, pasi që po të ekzistonte dashje për privim nga jeta këtë ka mundur ta bëjë lehtë pasi që nuk ka pasur ndonjë pengesë për realizimin e saj, për çka gjykata vendosi qe ta liroje te akuzuarin nga aktakuza për te dy veprat penale për te cilat ai akuzohej si ne piken nje dhe dy te dispozitivit te aktakuzës.

Gjykata me rastin e vendosjes ne këtë qeshtje penale shqyrtoje mundësin e ri cilësimit te veprës penale bazuar ne provat e shqyrtuara ne shqyrtim gjyqësor në vepër penale sipas nenit 8 pika 3 lidhur me pikën 5 të Rregullores së UNMIKU-ut numër 2001/07 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, por për shkak te kalimit te afateve kohore nga kryerja e veprës penale duke pasur parasysh kalimin e afatit te parashkrimit absolut te ndjekjes penale, nuk beri fare ri cilësim e veprës penale.

Sa i përket veprës penale si në pikën tre (3) te aktakuzes dhe aktgjykimit, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për arsye se në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 06.07.2022, prokurori i shtetit u terhiq nga vepra penale nga neni 8.al.6. lidhur me al.2. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 7/01, mbi autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, pasi që e njëjta vepër është përfshirë në Ligjin për Amistinë, Ligji Nr.04L/09 e dt.11 Korrik 2013.

Pas heqjes dorë nga prokurori i shtetit nga ndjekja penale sa i përket veprës penale si ne pikën tre (3) të këtij aktgjykimi ndaj të akuzuarit, gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 363 parag.1 nen parag.1.1 të KPP-së, ka marrë aktgjykim me të cilin e ka refuzuar aktakuzën e Prokurorisë Publike te Qarkut ne Mitrovice PP.nr.246/2002, të dt.12.08.2002, sa i përket pikës tre (3) të aktakuzës ndaj te akuzuarit konkretisht për shkak të veprës penale nga neni 8.al.6. lidhur me al.2. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 7/01, mbi autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë.

Gjykata ne baze te dispozitës ligjore nga neni 282 par.1 dhe 2 pika 1.2 te KPP-se, në mënyrë të përhershme të pandehurit i konfiskon armen- pushkën automatike te markës AK-47 nr. serik 186009, të kal. 7.62 mm, ashtu që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi kjo arme të shkatërrohen nga Policia e Kosovës në rast se nuk evidentohet se arma është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale , gjykata e mori ne bazë të nenit 454 par.1 të KPP-së.

Palët e dëmtuara sipas aktakuzës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest te rregullt civil, ne baze te nenit 463 par.3 te KPP-se.

Nga si u tha me lartë e në mbështetje të nenit 364 par.1 pika 1.3 dhe nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

**Departamenti për krime te renda**

**P.nr.10/2011 me dt.05.07.2022**

***Procesmbajtësja***

**Shqipe Sejdiu**

***Kryetari i trupit gjykues***

**Mentor Hajraj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta ne ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.